

VENDIM
Nr.1681, datë 24.12.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR ROMANAT-PLEPA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Romanat-Plepa, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2190 (dy mijë e njëqind e nëntëdhjetë) m², tokë arë, të vlerësuar me çmimin 662 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë/ m², me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 1 449 780 (një milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 382 500 (treqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 1 449 780 (një milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2008, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të fillojë më 30.12.2008 dhe të përfundojë më 30.3.2009.
 7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE SHPRONËSOHEN, SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AKSIT RRUGOR
ROMANAT-PLEPA

PRONARI			ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISË	LLOJI I PASURISË	SIPERFAQJA (M ²)	ÇMIMI PËR NJËSI	VLERA LEKË	FSHATI	TOTALI (LEKË)	SHËNIME
NR.	EMËR	MBIEMËR									
1.	OSMAN	LOCI	1031	167/1	ARE	420	662	278040	ARAPAJ	278040	KONFIRMUAR NGA ZRPP
2.	SHKELQIM MANUELA	DAUTI DAUTI	1031	169/22	ARE	160	662	105920	ARAPAJ	105920	KONFIRMUAR NGA ZRPP
3.	DERVISH	ÇULLHAI	1031	169/16	ARE	190	662	125780	ARAPAJ	125780	KONFIRMUAR NGA ZRPP
4.	BESIM	ÇULLHAI	1031	169/27	ARE	40	662	26480	ARAPAJ	26480	KONFIRMUAR NGA ZRPP
5.	TOMORR	BRAKA	1031	169/26	ARE	223	662	147626	ARAPAJ	147626	KONFIRMUAR NGA ZRPP
6.	AVDYI	SHUAIP	1031	169/14	ARE	300	662	198600	ARAPAJ	198600	KONFIRMUAR NGA ZRPP
7.	HYSEN	SHUAIP	1031	169/13	ARE	120	662	79440	ARAPAJ	79440	KONFIRMUAR NGA ZRPP
8.	FADIL	SHUAIP	1031	169//12	ARE	130	662	86060	ARAPAJ	86060	KONFIRMUAR NGA ZRPP
9.	FLAMUR	SHUAIP	1031	169/11	ARE	96	662	63552	ARAPAJ	63552	KONFIRMUAR NGA ZRPP
10.	BESNIK	AVDYLI	1031	169/10	ARE	70	662	46340	ARAPAJ	46340	KONFIRMUAR NGA ZRPP
11.	MYFTAR	AVDYLI	1031	169/9	ARE	30	662	19860	ARAPAJ	19860	KONFIRMUAR NGA ZRPP
12.	JAKUP	AVDYLI	1031	169/8	ARE	99	662	65538	ARAPAJ	65538	KONFIRMUAR NGA ZRPP
13.	IBRAHIM	AVDYLI	1031	169/6	ARE	72	662	47664	ARAPAJ	47664	KONFIRMUAR NGA ZRPP
14.	HASIM	BEDRI	1031	169/5	ARE	87	662	57594	ARAPAJ	57594	KONFIRMUAR NGA ZRPP
15.	INAJETE	SHUAIP	1031	169/4	ARE	87	662	57594	ARAPAJ	57594	KONFIRMUAR NGA ZRPP
16.	BEQIR HALIT	MEHMETI SADUSHI	1031	169/3	ARE	66	662	43692	ARAPAJ	43692	KONFIRMUAR NGA ZRPP
		TOTALI				2190		1449780		1449780	

